

Hazir Mehemeti
Rifat Hamiti

Për nivelin
e parë

NJË BOTË PËR TË GJITHË

EMRI DHE NBIEMRI:

KLASA

SHKOLLA


VENDI

SHTETI

duk²gjini



A large, semi-transparent oval at the bottom left contains the letters of the Albanian alphabet in a curved arrangement: A B C Ç D D H E F G J Q K S V X Y Z H .





Hazir Mehmeti, Rifat Hamiti

Një botë për të gjithë

Fletore tematike
për nivelin e parë

duk^a_Dgjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Hazir Mehmeti, Rifat Hamiti


Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE -International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



PËRMBAJTJA

1. Klasa jonë.....	5
2. Shoqëria e Albanit	6
3. Në klasën tonë fliten shumë gjuhë.....	7
4. Në klasë e shoqëri ka rregulla.....	8
5. Unë flas shqip.....	10
6. Ne jemi nga trevat shqiptare.....	12
7. Festojmë së bashku.....	13
8. Urojmë e gëzohemi bashkë.....	14
9. Njerëzit me ngjyrë ylber në natyrë	15
10. Të barabartë	16
11. Flamujt janë simbole	17
12. Ngjyra që flasin	19
13. Shtete, gjuhë e flamuj.....	21
14. T'i njohim flamujt e popujve.....	23
15. Bukuritë e vendlindjes i shijojmë çdo vit.....	24
16. Qytete shqiptare	26
17. Ambienti rrethues	27
18. Hapësira të rrrethit tonë	29
19. Natyra që na rrethon	31
20. Shprehje dhe emra nga natyra	33
21. Unë jam pjesë e natyrës.....	35
22. Ajri dhe uji, ambiente ku ka jetë	37
23. Si ta ruajmë ambientin jetësor	39
24. Ta ruajmë rrithin tonë	40
25. T'i njohim dhe ruajmë bimët.....	41
26. Lulet në pranverë	42
27. Bimët kanë emra	43
28. Bimët kanë trup i cili rritet	44
29. Shpezët dhe ushqimi i tyre	45
30. Disa nga shpezët e buta	46
31. Perimet dhe pemët	47
32. Pemët dhe perimet janë të domosdoshme	48
33. Pemët e jugut dhe pemët tjera.....	49
34. Mësoji dhe shijoi pemët	51
35. Të njëjtë dhe të ndryshëm	53
36. Sa jemi të ndryshëm	55
37. T'i mësojmë emrat e shtazëve.....	57
38. Shtazët e egra dhe shtazët shtëpiake	58
39. Vëlla Alban /këngë/	59
40. Shumë urime për ty /këngë/	60



1. Klasa jonë

Në klasën tonë jemi shumë nxënës e nxënëse. Unë dhe Arta jemi nga Shqipëria e Kosova. Të tjerët janë nga shumë shtete të botës. Të gjithë mësojmë së bashku. Në mësim flasim në gjuhën e shkollës, kurse në shtëpi gjuhën e atdheut. Në klasën tonë qëndrojnë të varur flamujt e shteteve nga janë shokët e shoqet e klasës. Në një pllakat është shkruar në të gjitha gjuhët edhe përshëndetja: Mirëmëngjesi! Pra, klasa jonë është një botë e vogël.

1. Shoqet e shokët e tjerë përshëndeten në gjuhët e tyre.
2. Detyrë: Përshëndetjet (Mirëmëngjesi! Mirupafshim!) në gjuhët e ndryshme

Mirëmëngjesi!

3. Detyrë: Ngjyros flamurin kombëtar.
4. Detyrë: Vizato dhe ngjyrose edhe flamurin e shoqes tënde/shokut tënd të ngushtë.



2. Shoqëria e Albanit

Albani ka shumë shokë të klasës. Ata janë nga vende të ndryshme të botës. Të gjithë mësojnë bashkë. Albani, pas dite, mëson shqip me shoqe e shokë shqiptarë. Ata mësojnë lexim, shkrim, por edhe këngë e vjersha të bukura. Edhe ti ke shumë shoqe e shokë.

1. Shkruaj emrat dhe ngjith fotografitë apo vizatoji shokët e shoqet e tua!

(_____) (_____) (_____) (_____)

Trego për lojërat që ke mësuar nga shoqëria!

2. Shkruaj emrat e lojërave!



2. Shkruaj! "Trimi i mirë me shokë shumë" _____

3. Në klasën tonë fliten shumë gjuhë

1. Në klasën tonë nxënësit janë nga shtete të ndryshme. Hansi është nga Gjermania, Albani nga Shqipëria, Angelika nga Hungaria, Ajshja nga Turqia, Maria nga Suedia, Luigji nga Italia dhe Zhaku nga Franca.

Ata janë shokë e shoqe të mira. Mësojnë së bashku në gjuhën e shkollës. Në shtëpi secili flet edhe në gjuhën amtare. Albani mëson dhe e flet mirë gjuhën shqipe.

Shteti:	Kombi:	Gjuha:
Shqipëri	shqiptar	shqip
Gjermani	gjerman	gjermanisht
Angli	anglez	anglisht
Francë	francez	frëngjisht
Turqi	turk	turqisht
Greqi	grek	greqisht
Hungari	hungarez	hungarisht

Detyrë: Përgjigjuni pyetjeve!

1. Si flet Hansi? _____ . (gjermanisht)

2. Si flet Albani? _____ . (shqip)

3. Si flet Angelika? _____ . (hungarisht)

4. Si flet Ajshja? _____ . (turqisht)

5. Si flet Maria? _____ . (suedisht)

6. Si flet Luigji? _____ . (italisht)

7. Si flet Zhaku? _____ . (frëngjisht)

2. Shkruaj përvendetje që di në gjuhët e shokëve tuaj!

_____ _____ _____


3. Shkruaj tri përvendetjet gjatë ditës kur takohesh me të tjerët!

në mëngjes

në mesditë

në mbrëmje

4. Cila gjuhë flitet në shkollën tua? _____



4. Në klasë e shoqëri ka rregulla

Në klasë mësojmë së bashku. Të gjithë i respektojmë rregullat e shkollës. E dëgjojmë mësuesin kur shpjegon mësimin. Kujdesemi për pastërtinë në klasë. Të gjithë e duam dhe e respektojmë njëri-tjetrin. Secili prej nesh ka diçka të veçantë. Dikë e duam më tepër e tjetrin më pak. Kjo varet nga secili se si sillet me të tjerët.

Në klasë ka edhe rregulla të tjera. -Në klasë nuk bëjmë zhurmë as nuk vrapojmë. -Lajmërohem kur duam t'i themi mësueses/ mësuesit diçka. -Ne i ndihmojmë njëri tjetrit në mësim.

Bisedoni për këto veti dhe sjellje të njerëzve.

1. Shëno, çka gjen të bukur çka të keqe në shoqërinë tënde të klasës.



ngatërresa përqesh shoqërinë



i shoqërueshëm



ndihmëtar



i ndershëm



fjalëshumë



fjalëpak



gënjeshtar



i dashur



besnik



i qeshur



sulmon të tjerët



bashkëpunues



5. Unë flas shqip

Albani mëson me shokët e shoqet në gjuhën e shkollës. Ai pas dreke një herë në javë mëson shqip. – „Ti Alban do të bëhesh i ditur. Ai që mëson disa gjuhë bëhet i ditur” - i kishte thënë gjyshja.

1. Shkruaj në cilën gjuhë flet me prindërit e tu! _____



2. Shkruaj në cilën gjuhë flet me motrat dhe vëllezërit! _____

3. Shkruaj në cilën gjuhë mëson në shkollë! _____

4. Shkruaj emrat e vendeve ku flitet gjuha shqipe:



6. Ne vijmë nga trevat shqiptare

Gjuha shqipe flitet gjithkund ku shqiptarët i kanë trojet e veta. Iliri është nga Struga, Albani nga Shqipëria, Besa nga Presheva, Gjergji nga Ulqini, Blerta është nga Kosova. Të gjithë flasin shqip. Po ti, nga je? Shkruaje!

1.

Emri _____, Mbiemri: _____

Vendi nga je: _____

Vendi ku jeton: _____; gjuha e shkollës: _____

gjuha amtare _____.

2.

a) Prej nga është Blerta? Blerta është nga _____.

b) Prej nga është Iliri? Iliri është nga _____.

c) Prej nga është Albani? Albani është nga _____.

d) Prej nga është Gjergji? Gjergji është nga _____.

e) Prej nga është Besa? Besa është nga _____.

Si flasin këta nxënës shqiptarë me prindërit e tyre?

Ata me prindërit e tyre flasin _____.

3. Plotëso fjalitë me fjalët nga korniza!

shqip mësoj gjuhën

Unë flas _____ me prindërit dhe të afërmit e mi.

Në shkollë unë _____ në gjuhën e shkollës.

Unë e dua _____ time.

Në shkollë ne flasim _____.

7. Festojmë së bashku

Secili u gëzohet festave. Edhe ne gëzohemi kur vijnë ato. Me shumë kënaqësi përgatitsim gjëra për të festuar sa më mirë. Në veçanti na gëzon festa e Vtitit të Ri. Së bashku me mësuesen në shkollë gatuajmë biskota me forma të ndryshme, vizatojmë dhe e ngjyrosim bredhin. Mua më pëlqejnë dritat shumëngjyrëshe, Besës i pëlqejnë dhuratat, Ilirit yjtë shumëformësh. Shpesh themi sikur nuk ka më shpesh festa të tillë.



Para Vtitit të Ri festohen Krishtlindjet. Ne urojmë së bashku: Urime Krishtlindjet! Albani i feston krishtlindjet. Nëna e tij solli në klasë një pako biskota dhe çokolata. Ne i shijuam me kënaqësi dhe uruam.

1. Detyrë: shkruaj në gjuhën e shkollës këto fjalë:

Viti i Ri _____, festë _____, bredh _____,

urime _____, krishtlindje _____, biskota _____,

dhurata _____,

2. Shkruaj me çka e zbukuronit bredhin!

3. Shkruaj çka të pëlqen më shumë në një festë!

8. Urojmë e gëzohemi bashkë

Në botë ka shumë besime, andaj ka edhe shumë festa. Atyre u gëzohemi të gjithë. Edhe pse i festojmë ndaras, të gjithë gëzohemi dhe e urojmë njëri-tjetrin. Për Krishtlindje të gjithëve na dhurohen biskota, çokollata e dhurata tjera. Për festen e Bajramit na dhurojnë ëmbëlsira e dhurata tjera.



1. Shkruaj emrat e festave në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e shkollës!

Krishtlindjet

Pashkët

Bajrami

Të shtojmë njohuritë

Cila festë të pëlqen më shumë? Mua më _____.

Çka u dhurohet fëmijëve për festen e Krishtlindjeve? Për Krishtlindje _____

Çka u dhurohet fëmijëve për festen e Bajramit?

Për Bajram _____.

Çfarë shije ka bakllava? Bakllava ka _____.

2. Pëershkruej si i festoni në familje! _____

9. Njerëzit me ngjyrë ylberi në natyrë

Njerëzit janë të gjithë vëllezër. Ata jetojnë në kushte të ndryshme qe nga poli i ftohët deri tek ekuatori i ngrohët. Ngjyra e tyre nuk është e njëjtë. Kjo nuk i pëngon njerëzit ta duan njëri tjetrin. Ata janë bashkë gjithkund: në sport, në koncerte, në festa.



Çdo gjë shumëngjyrëshe në natyrë është e bukur;
lulet, ylberi, gjethet po edhe njerëzit.
Kush i jep ngjyrat ylberit? /Dielli/

Të gjithë janë të lumtur.
Vëllezër të një bote.



10. Të barabartë

Pa marrë parasysh ngjyrën, të gjithë njerëzit janë të njëjtë. Ata janë vëllezër dhe kanë dëshira të njëjtë: të punojnë, të mësojnë, të festojnë, të luajnë. Fëmijët e tërë globit me ëndje dëgjojnë përralla. Ato janë shumë të bukura. Po ashtu edhe përrallat shqiptare.



Njerëzit emigrojnë nga vende të ndryshme në tërë botën. Ata kërkojnë shoqëri me të tjera, të jetojnë e të punojnë së bashku. Prindërite Albanit dhe të Besës kanë ardhur nga trevat shqiptare.

2. Nga është Albani e Shpresë? _____

3. Ku do të dëshiroje të migroje po pate mundësi? _____

4. Shkruaj emrat e shokëve/shoqeve tua dhe vendin prej nga vijnë!

5. Shkruaj në gjuhën e shkollës fjalët e dhëna më poshtë!

glob _____, atdhe _____,

prindër _____, shoqëri _____,

6. Detyrë: Shkruaj me disa fjali një ngjarje të bukur të përjetuar me të tjerët! _____

11. Flamujt janë simbole

Në botë jetojnë shumë popuj. Ata kanë gjuhën dhe flamurin e tyre. Flamuri është simbol i një kombi. Kur e shohim një flamur, e dimë se për cilin shtet bëhet fjalë. Kur e dëgjojmë dikë duke folur në gjuhën e vet, e dimë se cilit komb i takon ai apo ajo.

Edhe shqiptarët, kudo që jetojnë, kanë flamurin e tyre kombëtar. Ai ka fushë të kuqe dhe shqiponjën e zezë dykrenore në mes. Gjuha e tyre është gjuha shqipe. Në botë jetojnë shumë popuj: **shqiptarët, grekët, malazezët, maqedonët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, gjermanët, francezët, anglezët, italianët, turqit, hungarezët, suedezët, amerikanët, arabët, kinezët, rusët, etj.**





Nebih Muriqi
Peisazh

Europa është kontinent si edhe:
Amerika, Azia, Afrika, Australia etj

Atdheu ynë është pjesë e EUROPËS.

1. Vizatoje e ngjyrose flamurin e shtetit ku jeton dhe flamurin kombëtar!



Ngjyrose globin:

1- kaltër dhe 2 -gjelbër



Globi _____



Rexhep Goçi:
Ura e Shenjtë

12. Ngjyra që flasin

Kur e shohim një flamur, e kuptojmë se i cilit shtet është. Albani me krenari e tregon flamurin kombëtar kuqezi me shqiponjën dy krerësh. Flamurin e ngrehim në festë. Ngjyrat në flamur kanë një kuptim. Ato tregojnë diçka nga veçoritë e popullit.

shqiptarët, maqedonasit, italianët, malazezët, grekët.

1. Shkruaj emrat lart dhe mësoji!


Këta janë popujt fqinjë: _____



2. Detyrë: Lidh shtetin me flamurin përkatës, mëso emrat!



Kosova




Maqedonia



Greqia



Shqipëria



Mali i Zi



Italia




13. Shtete, gjuhë e flamuj


Popujt jetojnë në shtete. Ata mësojnë në gjuhë të ndryshme. Secili e respekton gjuhën e vet dhe të tjetrit. Edhe këtu në shtetin ku jetojmë mësohet të flitet dhe shkruhet gjuha e nënës. Gjuhët janë urë lidhëse në mes të njerëzve. Sa më shumë gjuhë të di, aq më shumë vlen.

1. Shkruaj emrin e shtetit ku jeton! Shkruaj emrin e shtetit prej nga je!

2. Ngjyrose flamurin kombëtar!



3. Ngjyrose flamurin e shtetit ku jeton!



3. Mëso shtetet dhe gjuhët

**Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Austria, Gjermania, Franca,
Zvicra, Italia, Greqia, Belgjika, Anglia, Suedia, Norvegjia**

Shteti	Shteti	Shteti	Shteti
Shqipëria	Kosova	Maqedonia	Serbia
Gjuha shqipe	Gjuha shqipe	Gjuha maqedone + Gjuha shqipe +	Gjuha serbe ++

Shteti	Shteti	Shteti	Shteti
Mali i Zi	Austria	Gjermania	Franca
Gjuha malazeze	Gjuha gjermane	Gjuha gjermane	Gjuha frënge

Shteti	Shteti	Shteti	Shteti
Zvicra	Italia	Greqia	Belgjika
Gjuha gjermane ++	Gjuha italiane	Gjuha greke	Gjuha frenge Gjuha flamane

Shteti	Shteti	Shteti	Shteti
Anglia	Suedia	Holanda	Norvegjia
Gjuha angleze	Gjuha suedeze	Gjuha holandeze	Gjuha norvegjeze

Të shtojmë njohuritë: Kur bisedojmë për dikë se cilën gjuhë flet, pa e përdorur fjalën „gjuhë“, atëherë themi: shqip, maqedonisht, serbisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, greqisht, anglisht, suedisht, holandisht, norvegjisht etj.

- Në Zvicër fliten tri gjuhë: gjermanishtja, frëngjishtja dhe italishtja.

-Gjuha shqipe flitet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, Mal të Zi, etj.

14. T'i njohim flamujt e popujve

Në klasën tënde ka shumë shokë e shoqe nga shtetet tjera. Ata i njohin flamujt e tyre kombëtar.

1. E njeh ti flamurin kombëtar? Shkruaj një fjali për të!

2. Shkruaj emrat e disa shteteve që di!

3. Si duket flamuri i vendit ku jeton? Shkruaj sa ngjyra ka!

4. Qarko ngjyrat që i ke përdorur në kornizën poshtë!

e bardhë/ e kuqe/e kaltër/portokalli/e zezë /afe /e gjelbër/e verdhë /e zezë



15. Bukuritë e vendlindjes i shijojmë çdo vit

Vendlindja e të parëve tanë është e bukur. Ajo ka detin, fushat, malet, liqenet e shumë lumenj të pasur me ujë. Edhe pse unë jam lindur në mërgim, vendlindja e prindërve të mi është edhe atdheu im. Pushimet verore i kalojmë përherë në vendlindjen e prindërve të mi. Gati çdo vit shkojmë për t'u larë e rrezitur në plazhin e Ulqinit, Durrësit, Vlorës, Sarandës etj. Por nuk lëmë pa vizituar edhe qytete e lapidarë të dëshmorëve që ranë për lirinë e Atdheut.



T'i mësojmë fjalët dhe shprehjet:
e të parëve - e prindërve e gjyshërv
në mërgim - jashtë atdheut
lapidarë - përmendore

Të shtojmë njohuritë:

- Deti ynë quhet Deti Adriatik.
- Shqipëria ka edhe Detin Jon.
- Në Kosovë ka shumë lapidarë, por më i rëndësishmi është ai i Komandantit legjendar Adem Jashari, në Prekaz.

Detyrë:

Pyetni prindërit edhe për lapidarë të dëshmorëve të tjerë dhe shkruani ata në fletoren e detyrave shtëpiake

1. Si quhet atdheu yt? _____
2. Ku kanë lindur prindërit: nëna _____ babai _____
3. Ku ke lindur ti? _____

Pushimet verore në vendlindje i kalojmë në vende të ndryshme:

- 1.Detyrë: Shkruaj emrat e qyteteve bregdetare nga korniza në vija
Ulqini, Durrësi, Vlora, Saranda, Shëngjini, Kavaja, Velipoja, Himara.

Detyrë: Shiko hartën dhe shënoji ku gjenden qytetet bregdetare.



16. Qytete shqiptare

Tirana, Prishtina, Shkupi, Shkodra, Prizreni, Tetova,
Gjirokastra, Berati, Struga, Peja, Korça, Gjakova, Ulqini

Detyrë:

Me ndihmën e mësuesit
shkruaj cilat qytete gjenden në:

Shqipëri: _____



Nimon Lokaj
Pishat e Deçanit

Kosovë: _____

Maqedoni: _____

Mal të Zi: _____


17. Ambienti rrethues

Gjatë vitit ambienti që na rrëthon nuk është i njëjtë. Ai ndryshon sipas stinëve të vitit.


1. Ngjyrosi këto ilustrime sipas ngjyrës që kanë në natyrë dhe shkruaj nga dy fjali për secilën pamje. Përdori fjalët në kornizë që ta kesh më lehtë!



p _____



v _____



d _____



v _____

natyra në pranverë / dielli / natyra në verë / natyra në dimër
natyra në vjeshtë/ moti i nxehthë/i ftohtë/ piqen pemët / në pushimet

18. Hapësira të rrethit tonë

1. Shkruaj emrat nën vizatimin përkatës!
Ngjyros sipas dëshirës!

qyteti, fshati, liqeni, oaza, ishulli.


2. Lexo dhe përshkruaj fjalitë!




Në qytet ka shumë _____ / njerëz /



Në fshat ka shumë _____. /gjelbërim/




Në det lundrojnë _____ /anijet/



Në liqen ka shumë _____ /peshq/



Oaza është burimi ujor në ____ /shkretëtirë/



Ishulli është tokë e rrethuar me ____ / ujë/



19. Natyra që na rrethon

Gjithçka që na rrethon është natyrë. Natyrë është toka, dielli, hëna, lumenjtë, liqenet, bimët, kafshët, njerëzit, ajri, mjegullë, shiu, dëbora e shumë gjëra tjera. Natyra është pa kufi.

Natyra e gjallë janë bimët e kafshët. Natyrë jo e gjallë janë të gjitha të tjerat.

1. Ngjyros vizatimet dhe shkruaj emrat e tyre!


**re, shiu, vetëtima, lule, gjethe, bredhi, kodra, lena, shpezë,
lisi, flutur, merimanga, kërmilli, drenusha.**



r _____

sh _____




v _____



l _____

b _____

k _____







gj _____

L _____

L _____

g _____



f _____

m _____

k _____

d _____

2. Shkruaj emrat e bimëve!

3. Çka të pëlqen më shumë në natyrë? _____

20. Shprehje dhe emra nga natyra


Fëmijët janë pjesë e natyrës. Me sjellje të drejtë fëmijët e ruajnë natyrën. Hedhja e mbeturinave duhet të bëhet në vendet e caktuara që ta ruajmë natyrën.

1. Shkruaj emrat nga korniza dhe ngjyros ato që të pëlqejnë më shumë!


lumi, dielli, deti, lijeni, burimi, ishulli, pylli, ujëvara,
qielli, ylberi, hëna, yjet, shpezët, shtazët, bimët.




l _____




d _____



d _____




l _____



b _____



i _____



u _____

p _____

2. Renditi fjalët në fjali: ka ujë të Burimi pastër. _____

3. Ku i hedh ti mbeturinat? _____

21. Unë jam pjesë e natyrës

1. Njerëzit, bimët, kafshët janë pjesë e natyrës së gjallë. Secili nga ne i takon kësaj. Pra edhe ti, unë e të tjerët. Ne jemi të lidhur me botën që na rrëthon. Fushat, malet, qielli, yjet, dielli, hëna, ajri janë pjesë e rrëthit tonë jetësor.

1. Njerëzit.

Qielli është i kaltër gjatë ditës. Natën errësohet. Atëherë duken yjet dhe hëna.

1. Si duket qielli natën?

- a/ i kaltër
- b/ i errët
- c/ i gjelbër
- d/ me yje




2. Si duket hëna?

- a/ rrëth
- b/ gjysmërrëth
- c/ formë drapëri

2. Ngjyros!

fusha (gjelbër), lumi (kaltër), qielli (kaltër), dielli (verdhë), druri (kafe).



3. Shkruaj numrat e emërtimeve brenda rrethit!


1-majë bjeshke 2-bjeshkët 3-pjerrësia 4-shpat mali 5- lugina




22. Ajri dhe uji, ambiente ku ka jetë

Ajri na rrethon në hapësirë. Pa ajër nuk mund të jetohet. Në ajër fluturojnë insektet dhe shpezët. Nga lëvizjet e ajrit formohen era e stuhitë.

1. Cili insekt bën dritë natën? X _____.



mushkonja



merimanga




xixëllonja

2. Mjaltin e marrim nga: B _____.



flutra



bleta







milingona

Deti

2. Në det jetojnë shumë shtazë: peshq, gaforre, guaca, ylldeti.




balena, peshku, gaforre, guaca



3. Çka bartet me anije? Shkruaj!

njerëz, mallra,

ylldeti, oktapodi, peshkaqeni, delfini



3. Shkruaj këta emra në gjuhën e shkollës: balena, peshku, delfini, foka, peshkaqeni.

b _____ - _____.

peshku - _____ . delfini- _____ .

peshkaqeni - _____ . guaca- _____ .

gaforrja - _____ .

23. Si ta ruajmë ambientin jetësor

Aty ku jemi ne është ambienti ynë. Ne jetojmë në natyrë me gjallesat tjera. Ato janë të dobishme sikur edhe ne. Kujdesi ndaj tyre është detyrimi ynë në ruajtjen e ambientit

1. Shënoi çfarë është e drejtë (+) e çfarë e gabuar (-) dhe ngjyros sipas dëshirës!



()



()



()



()



()



()

2. Shkruaj fjalët

drunjtë, kërpudha, gjelbërim, zjarr, pastrim, kujdes, lojë, qetësi

24. Ta ruajmë rrethin tonë

1. Veprimet e mira shënojti me ☺, veprimet e këqija shënojti me ☹
- sillet pa kujdes i frikëson shtazët nuk hedh sende
ndez zjarr sillet me kujdes nuk ndez zjarr
i prek kërpudhat i ushqen shpezët këput degë

2. Trego me një fjali, çka të pëlqen ty në natyrë! _____

3. Kur të pëlqen më shumë natyra?

- a) në pranverë
- b) në verë
- c) në vjeshtë
- d) në dimër

4. A ke parë ndonjëherë çerdhe shpendësh nga afër? Po, jo?

- a) po, por me kujdes
- b) jo, asnjëherë
- c) po, nganjëherë

5. A duhet t'i prekim zogjtë në çerdhe?

- a) po, por me kujdes
- b) jo, asnjëherë
- c) po, nganjëherë

6. Albani nuk i dëmton drunjëtë, barin dhe lulet. Ato e zbukurojnë natyrën.

Lulet nuk duhet shkulur me rrënje.




25. T'i njohim dhe t'i ruajmë bimët

Bimët janë gjallesa. Ato rriten dhe shumëzohen. Që të rriten iu duhet dielli, uji, ajri dhe dheu. Shumë bimëve gjatë dimrit u bien gjethet, kurse disa i mbajnë.



1. Nën figurë shkruaj emrat përkatës!

Bimë gjethembajtëse - bredhi, bimë gjetherënëse - molla





2. Albanit i pëlqejnë bimët me lule të bukurat.

trëndafili, karafili, vjollca, lulëkuqja



3. Ngjyrosi gjethet!




Të shtojmë njohuritë:

Bimët e marrin ushqimin përmes rrënjeve. Bimët ajrin e marrin përmes gjetheve. Lëngu që thihin bletët nga lulet quhet nektar

26. Lulet në pranverë

Në pranverë natyra gjelbërohet. Lulet çelin. Ato kanë ngjyra të bukura. Në to bletët e mbledhin nektarin për të bërë mjaltë. Mjalti është ëmbëlsirë natyrore e shëndoshë.

1. Ngjyros sipas dëshirës dhe shkruaj emrat shqip dhe në gjuhën e shkollës!



n _____

t _____


l _____

2. Nga lulet **formohen frytet**. Gjethet krijojnë **ushqim për rritje**. Rrënjet e thithin **ujin**.

a. Nga lulet _____.

b. Gjethet krijojnë _____.

c. Rrënjet e thithin _____.



lulja, gjethet, rrënjet

3. Qarkoje emrin e stinës së vitit e cila të pëlqen më shumë. Shkruaj emrat poshtë në gjuhën e shkollës!

pranvera

vera

vjeshta




dimri

27. Bimët kanë emra

Bimët janë pastruesit më të mirë të ajrit. Atyre ndryshe ju thonë mushkëritë e natyrës. Nga bimët natyra e merr ngjyrën e gjelbër. Ndaj bimëve duhet pasur kujdes.

1. Detyrë: Shkruaj përsë bimëve u themi mushkëri të natyrës! _____
_____.

2. Disa bimëve u themi: / lule, shkurre, bimë drunore / Shkruaj nën figura!



l _____




sh _____

b _____

d _____

Bimët kanë fruta me forma të ndryshme. Me fruta ushqehen njerëzit e shtazët.

2. Shkruaj emrat dhe ngjyros sipas dëshirës!




b _____

l _____

g _____

p _____

3. Shkruaj emrat e këtyre luleve!



l _____

m _____

1 _____

k _____

28. Bimët kanë trup i cili rritet

Bimët shumohen me frutat e tyre. Ato zhvillohen nga lulet. Farat mbijnë dhe rritet bima e re. Nga lulet formohen frytet. Ato kanë brenda fara por edhe shumë ushqim për shtazët dhe njerëzit.

1. Detyrë: Me çka shumohen bimët? B _____.

2. Cila nga lulet të pëlqen më shumë? Shkruaja emrin dhe vizatoje në kornizë!

(_____)



3. Bimë e shtazë jetojnë së bashku. Ato nuk mund të jetojnë të ndara.

Detyrë: Ngjyros sipas dëshirës!




29. Shpezët dhe ushqimi i tyre

Shpezët kanë pupla dhe sqep që i dallojnë. Puplat ua mundësojnë fluturimin. Me sqep shpezët e kapin ushqimin. Disa shpezë si: dallëndyshja, lejleku, bilbili dhe qyqja, në vjeshtë fluturojnë në jug. Ato kthehen përsëri në pranverë. Këto quhen shpezë shtegtarë.

1. Detyrë: Shkruaj emrat e shpezëve shtegtarë!

lejleku, dallëndyshja, qyqja, turreci, rosa e egër, pata e egër



2. Shpezët grabitëqare ushqehen me prenë e tyre. Ato kanë kthetra të fuqishme. Shqiponja është një shpend grabitqar.

Detyrë:

Shkruaj emrat e shpezëve grabitqarë! Shqiponja, huti, papagalli, qukapiku, pinguini



Sh _____ h _____ p _____ q _____ p _____

3. Shpezët ushqehen me fruta, bimë, krimba, insekte dhe me farat e drithërave si: gruri, misri, elbi, thekra, tershëra, manaferra, arra, lajthia.

4. Detyrë: Shkruaj emrat nën figurën përkatëse! / gruri, manaferra, kaça, qershia, arra /



g _____ m _____ k _____ q _____ a _____

4. Shkruaj emra të shpezëve që i di!

5. Cila shpezë e kopjon njeriun kur flet:

a) rosa, b) pula, c) papagalli,

Cila shpezë ka sqep të fortë me të cilin e shpon trungun e drunjtë:

a) shqiponja, b) qukapiku, c) dallëndyshja,

Cila shpezë ka këmbë e sqep të gjatë dhe jeton në këneta:


a) pinguini, b) bilbili, c) lejleku

Cila shpezë është madhe dhe nuk mund të fluturojë:


a) struci, b) pëllumbi, c) huti

30. Disa nga shpezët e buta


1. Shkruaj emrat shqip dhe në gjuhën e shkollës!



(pellumbi)




(pata)




(rosa)


2. Nga shpezët shtëpiake kemi dobi. Prej tyre marrim: **vezë, pendë, mish.**




(gjeldeti)



(zogjtë)



(pula)



(krahët)

(gjeli)

(bishti)




(këmbët)





31. Perimet dhe pemët

Albanit i pëlqejnë ushqime nga perimet dhe pemët. Ato janë të shëndetshme. Vitaminat që i marrim gjatë ushqimit me to na duhen për rritje dhe zhvillim. Para se t'i hamë, duhet larë mirë.

1. Shkruaj emrat shqip, në gjuhën e shkollës dhe ngjyrosi!


speci, kastraveci, portokalli, kajsia, limoni, ananasi, pjeshka, fiku.





2. Shkruaj pjesët e frytit

**bishti,
lëvorja,
farat,
shtëpiza e farave,
ushqimi.**




32. Pemët dhe perimet janë të domosdoshme

1. Zbulo emrat e pemëve dhe shkruaj nga një fjali për secilën!

piqet, thartë, vaj, vjeshtë, reçel, kuqe, bërthama,
ëmbël, verdhë, shijshëm, lëngë pjeshke, kompot

	d		r	dh			Dardha hahet kur të piqet _____.
	l	i			n	i	Limoni është i _____.
	u	ll		r			Nga ulliri nxirret _____.
	rr		sh				Rrushi piqet në _____.
	k	a		s		a	Nga kajisia bëhet _____.
	sh		g	a			Shega është e _____.
	q	e		sh		a	Qershia ka _____.
	f		k				Fiku ka shije të _____.
	b				n	e	Banania ka ngjyrë të _____.
	k		v				Kivi është i _____.
	p	j			k		Nga pjeshka punohet _____.
		o		a			Kur mollët zihen punohet _____.

Perimet: **bizelja, sallata, hudhra, karota, qepa, rrepa, domatja.**



2. Ndaj pemët nga perimet. Shkruaj emrat shqip dhe në gjuhën e shkollës!

Perimet

Pemët

33. Pemët e jugut perimet tjera





Pemëve që rriten në vendet e nxeha, në jug, ju themi pemët e jugut.

Pemët tjera rriten edhe në vendet ku është më ftohtë.





1. Shkruaj emrat shqip dhe në gjuhën e shkollës! Ngjyros!

portokalli, limoni, bananet, shega, dardha, molla, qershitë, kumbullat

2. Pemët e jugut



3. Pemët tjera



4. Ndaj pemët e jugut ngapemët tjera!


qershia, kumbulla, portokalli, limoni, molla, arra,
shega, mandarina, dardha, kivi, pjeshka, ulliri, ananasi, kajsia.

Pemët e jugut _____

Pemët tjera _____

34. Pemët, mësoi dhe shijoi

Albani vendosi t'i ndihmojë babait në përgatitjen e një sallate pemësh. Ai shtoi në pjatë të veçantë këto pemë, shkruaj fjali sipas figurave!



Albani vuri në sallatë katër

Albana vuri në sallatë tri

dardha, molla, vile, rrushi, portokaj, ananas, banane, shegë



35. Të njëjtë dhe të ndryshëm

Në botë jetojnë shumë popuj. Të gjithë jemi vëllezër. Kudo ku janë fëmijët e duan paqen e lirinë. Ata kanë të njëjtat dëshira. Duan shoqëri, gëzim, këngë e lojëra. Dikush e do një lodër të kuqe, tjetri të bardhë, i treti të verdhë, të gjithë me radhë.

1. Ka njerëz që nuk e duan njëri-tjetrin. Kjo nuk është mirë.

Çfarë mendon ti? _____

1. Çdo zog ka një cicërimë.



Çdo fëmijë e do lirinë.

2. Secili zog ka ngjyrën e tij.
Edhe njerëzit kanë ngjyra .
Të gjithë të bukur
i krijojnë natyra.

Po ju fëmijë, çka mendoni?
Bisedoni me shokun, shoqen!

Fëmijët në fotografi janë me ngjyra të ndryshme.
Ata e duan njëri-tjetrin.
Shoqëria e tyre është e hareshme.



36. Sa jemi të ndryshëm

Shokët dhe shoqet tuaja nuk janë të njëjtë. Ata ndryshojnë. Secili i ka veçoritë e tij. Njëri është më i vogël, tjetri më i trashë. Njëri ka flokë të zezë, tjetri ngjyrë kafe, njëri ka sy të zezë, e kështu më radhë.

1. Shiko figurat, krahasoji dhe shkruaj vetitë e tyre!



/ e lodjur / e trashë flokëgjatë / i buzëqeshur flokëgjatë / flokëshkurtër me ngjyrë
/ fytyrë zgjatur flokëshkurtër / flokëshkurtër kaçurrel /

2. Shikoje shokun apo shoqen tende. Në figurë ngjyros dhe vizato ashtu sipas modelit të shokut apo shoqes!



ngjyra e flokëve (*e zezë, e kuqe, kafe, e verdhë*)

forma e flokëve (*të drejtë, të shkurtë, kaçurrela, të gjata*)

i gjatë, i shkurtër

3. Krahaso veten me shokun tënd! Shkruaj!

1. Unë jam më i shkurtër se _____

2. _____

3. _____











4. _____

më i shkurtër, më i gjatë, më i trashë, më i hollë.

37. T'i mësojmë emrat e shtazëve

Ne jetojmë në një ambient të rrethuar me bimë e shtazë. Ato janë pjesë e pandashme e jetës sonë. Shtazët jetojnë në tokë, në ujë, në ajër. Insektet janë organizma shtazore që fluturojnë.

1. Shkruaj në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e shkollës emrat e këtyre kafshëve!



2. Çka marrim nga shtazët shtëpiake?

Shkruaj katër fjali!

qumësht, mish, lëkurë, lesh.

1. Nga _____

38. Shtazët e egra dhe shtazët shtëpiake














Shtazët në natyrë i ndajmë në shtazë të egra dhe shtazët të buta. Nga shtazët e buta marrim prodhime që na duhen për ushqim, veshmbathje e nevoja tjera. Qumështi është ushqimi i parë yni që nga lindja. Prej tij përpunohen djathi, kosi, gjiza, tëlyeni.

1. Shkruaj nga cilat shtazë e marrim qumështin? Shkruaj ato që i di! _____

/ lopa, delja, dhia /

2. Qarko emrat e shtazëve shtëpiake!

ujku, derri i egër, vjedulla, iriqi, balena, plumi, ketri,
dhia, ariu, derri i bute, kaprolli, urithi, pula, huti



Ato që kanë penda

Ato që kanë qime

39. Vëlla Alban /këngë/

The musical notation consists of four staves of music for a single voice. The lyrics are as follows:

Vë - lla Al - ban! Vë - lla Al - ban!
A - po fle? A - po fle?
A dë - gjon ka mb - anat A dë - gjon ka mb - anat
Ding - dang - dong ding - dang - dong

Vëlla Alban! Vëlla Alban!
A po fle, a po fle?
A dëgjon kambanat, a dëgjon kambanat?
Ding-dang-dong, ding-dang-dong.



40. Shumë urime për ty / këngë /



Shum' u - ri - me për ty Shum' u - ri - me për ty Shum' u -



ri - me për ty Ro - ni Shum' u - ri - me për ty









Hazir Mehmeti, Rifat Hamiti
NJË BOTË PËR TË GJITHË
Fletore tematike

Botimi i parë

Botues:
Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:
Agim Lluka

Redaktor teknik:
Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje
Formati: 205x285

U shtyp në shtator 2010
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë
www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37: 811.18(076.1)(075.2)

Mehmeti, Hazir
Një botë për të gjithë: fletore tematike: për nivelin e parë/
Hazir Mehmeti, Rifat Hamiti. - Botimi 1. - Pejë:
Dukagjini, 2010. - 64 f. ilustr. me ngjyra; 27 cm.

1. Hamiti, Rifat

ISBN: 978-9951-05-232-0

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 297/2, të datës 22.06.2010*